

GEGNISHTJA SI POTENCIAL PËR PASURIMIN E STRUKTURËS LEKSIKORE TË GJUHËS SHQIPE

Farida RAMADANI (Zmijani)
Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Gegnishtja ka mbijetuar falë vlerave të saj historike e bashkëkohore. Trashëgimia kulturore, materiale dhe jomateriale (shpirtërore) përbën bazën e studimeve të çështjeve identitare. Këto rrënjë gjenden në trashëgiminë kulturore, të krijuar nga njerëzit dhe për njerëzit. Në të vërtetë ne duhet të synojmë të ruajmë format e fjalëve sepse kështu ne ruajmë edhe lidhjen me traditën e shkruar të gjuhës shqipe. Çështja e riafirmimit të gegërishtes letrare, ka të bëjë me riafirmimin e një pjese mjaft cilësore të kulturës kombëtare. Dialektet janë trajtuar si një burim i elementit të ri që mund të përfshihet në variantin standard. Gjuha standarde shqipe është një rast sui generis, pasi rruga e formimit të saj nuk është një nga rastet klasike të modaliteteve të formimit të standardeve. Por është fakt i pamohueshëm që toskërishtja është dialekti me më shumë prurje. Jup Kastratit bën një klasifikim të teksteve gramatikore, sipas kategorive të ndryshme të shkollave që ka dhënë një ndihmesë të dukshme për kristalizimin e saj. Prof. Shaban Demirajn, thekson se struktura morfologjike e shqipes letrare, në vija të përgjithshme, pasqyron strukturën morfologjike të gjuhës popullore. Synimi im është të jap një shembull të punës konkrete me materialin gjuhësor dialektor. Një punë e tillë, në përmasa më të gjera, dhe mbi baza të shëndosha shkencore, mendoj se ngjall edhe një debat të mirëfilltë mes specialistësh, që duhet të jenë protagonistët e politikës gjuhësore në gjithë trevat shqipfolëse, për ta mbrojtur dhe pasuruar shqipen standarde. *Fjalë kyçe: gegnisht, rrenjë, dialekt, kongres, bashkëtingëllore, zanore.*

ABSTRACT

Gegnishtja has survived thanks to its historical and contemporary values. Cultural, material and intangible (spiritual) heritage form the basis of studies of identity issues. These roots are found in the cultural heritage, created by people and for people. In fact, we should aim to preserve the forms of words because in this way we also maintain the connection with the written tradition of the Albanian language. The issue of reaffirmation of the literary gegërishta has to do with the reaffirmation of a very qualitative part of the national culture. Dialects are treated as a source of new element that can be included in the standard version. The standard Albanian language is a sui generis case, as the way of its formation is not one of the classic cases of standard formation modalities. But it is an undeniable fact that Tosk Albanian is the most influential dialect. Jup Kastrati makes a classification of grammar texts, according to different categories of schools that has given a visible help for its crystallization. Prof. Shaban Demirajn, emphasizes that the morphological structure of literary Albanian, in general, reflects the morphological structure of the vernacular. My aim is to give an example of concrete work with dialectal linguistic material. Such work, on a larger scale, and on sound scientific basis, I think evokes a genuine debate among specialists, who should be the protagonists of language policy in all Albanian-speaking areas, to protect and enrich standard Albanian.

Key words: gheg, root, dialect, convention, consonants, vowel.

GEGNISHTJA SI POTENCIAL PËR PASURIMIN E STRUKTURËS LEKSIKORE TË GJUHËS SHQIPE

Drejtskrimi ka disa kohë që ka krijuar përplasje në qarqet e gjuhëtarëve. Heqja e zanores “ë” të patheksuar është, ndër të tjera, çështja që ka krijuar pakënaqësi. Kryesisht në ndryshimet e miratuara me drejtskrimin e zanores “ë” të patheksuar, kur ajo del në kufi temash me prapashtesat. Kjo “ë”, në këto raste kur një fjalë formohet nga një temë me “ë” dhe një prapashtesë që nis me bashkëtingëllore, si për shembull fjala “anëtar”, të mos shkruhet. Pra fjala “anëtar” të shkruhet thjesht “antar”për të vazhduar me mosshkrimin e “ë”-së mbështetëse, për shembull “mjekësi” të shkruhet “mjeksi”. Mos shkrimi i “ë”-së në këto raste përfshin një numër shumë të madh fjalësh, të cilat mund të jenë me qindra e qindra. Pra, preket një pjesë e mirë e korpusit të fjalorit. Kjo nismë lë të hapur shtegun e mosshkrimit të “ë”-së edhe në fjalët e përbëra që kanë tema me “ë” dhe tema e dytë fillon me bashkëtingëllore si fjala “armëpushim”. Për këto lloj fjalësh mendoj të shkruhen pa “ë”. Gjithashtu mund të shfaq të tjera mendime, përveç zanores “ë”, në lidhje me zanoren “i” të patheksuar në grupet “ia”, “ie”, “io”, “iu” në fjalët e huaja. Në vend të “i”-së të shkruhet “j”. Këto janë rreth 900 fjalë sipas fjalorit të gjuhës shqipe të vitit 2006, i cili ka rreth 48000 fjalë të analizuara. Kjo tezë bazohet mbi faktin se në rregullat e drejtskrimit të gjuhës shqipe, në rezolutën e Kongresit të Drejtskrimit, thuhet se parimi themelor i drejtskrimit të gjuhës shqipe është parimi fonetik, pra fjalët duhet të shkruhen ashtu siç shqiptohen. Mirëpo këtu kemi një ekzagjerim të këtij rregulli sepse që në atë kohë është kundërshtuar në gjë e tillë. Pra jo parimi fonetik, por ai fonologjik. Domethënë fjalët shkruhen me fonemat që kanë. Çdo grafemë përfaqëson një fonemë dhe kjo buron që nga alfabeti i gjuhës shqipes që është i tillë. Ndryshe nga shumë gjuhë të tjera, në gjuhën shqipe çdo fonemë jepet me një grafemë që mund të jetë njëshe ose mund të jetë dyshe si “sh”-ja, “zh”-ja etj. Pra, këtu i jepet një peshë më e madhe parimit fonetik. Por, në të vërtetë ne duhet të synojmë të ruajmë format e fjalëve sepse kështu ne ruajmë edhe lidhjen me traditën e shkruar të gjuhës shqipe. Pra, nëse ne do të ecim me këtë shpejtësi dhe do t’i referohemi shqiptimit, por pa pasur studime për shqiptimin, studime fonetike me verbëri, mund të çojë në një gërryerje të formave të fjalëve dhe mund të bëjë që pas 100 ose 200 vitesh të mos lexohen veprat që janë shkruar sot.

Gegnishtja kolona bazë e gjuhës shqipe

Reformimin e mundshëm mund ta përshkruaj si një hapje ndaj “gegnishtes”, e cila, sipas meje, do të jetë prishja e murit të madh ndarës ose segregativ të standardit me “gegnishten”. Gegnishtja ka qenë shumë inovative për sa u përket “ë”-ve, duke u çliruar nga ato për shkak të veçorisë së saj reduktive duke vijuar më tej se “ë”-të në drejtskrim janë vetëm rëndesë. Vënia apo heqja e tyre nuk e ndryshon fjalën. Edhe “tosknishtja” ka tendencë të heqë “ë”-të e patheksuara, e ndikuar ose e tërhequr, siç shprehet, nga lokomotiva e madhe geqe. Reformat për “ë”-në e patheksuar që mund të ndërmerren po ndjekin trendin e “gegnishtes”. Në lidhje me koston e pallogaritshme ekonomike që mund të ketë zbatimi i reformës se kosto më të lartë do të paguajë gjuha shqipe nëse nuk reformohet standardi. Për të, Kongresi i Drejtskrimit të vitit 1972 është një dështim për faktin se aty nuk u arrit të dallohej se trendi i gjuhës shqipe në ditët e sotme do të ishte “gegnishtja”. Si rrjedhojë, reforma e standardit është një domosdoshmëri, duke e cilësuar standardin e gjuhës shqipe si anti- produktiv. Reformat e mundshme që mund të ndërmerren në bazë të volumit të materialit të ndryshuar ose të riparuar dhe të masës së prekjeve të strukturave të paracaktuara të Kongresit të Drejtskrimit të vitit 1972. Për të, ndryshimet do të ishin pozitive, nëse ato shkojnë në drejtim të arritjeve historike të “gegnishtes”. Në të kundërt, ato nuk do të jenë pozitive në rast se ndryshimet nuk do të motivoheshin në drejtimin e tyre të vërtetë duke marrë një shembull mbi tingullin e vogluem “ë”: Ë-ja mund të gjendet në mes ose në fund të fjalëve si:

a) Në mes të fjalëve do të shkruhet aty ku e lypë etimologjija e ku shqyptohet në tosknishte; për shembull: shëndet, rrëfye, këndue, etj.

b) Në fund të fjalëve ë-ja ka shërbim etimologjike e fonetik psh:

Te "Poema e mjerimit", Migjeni mund të quhet "poeti i të mjervet" dhe vepra e tij një "poemë mjerimi" e vazhdueshme e ndërpreme prej hovesh të flakta për me i shpëtue këtij mjerimi fatal. Poezia e Migjenit asht gati me prekë zenitin e vet. Mbas endjes së shkurtër ndër kujtimet e lumnís dallimet konvencionale mes së vërtetash dhe së rrëjshmesh janë false.

1. Së pari, gjatë gjithë historisë së gjuhësisë shqiptare, gjuhëtarët gegë janë përpjekur në mënyrë të ndërgegjeshme për njësimin e gjuhës shqipe. Dhe jo vetëm kaq, po ata edhe kanë punuar me këmbëngulje në këtë drejtim. Tjetër, pastaj, është rruga që kanë ndjekur për ta realizuar këtë njësim.
2. Së dyti, asnjë gjuhëtar nuk e ka mohuar e as kundërshtuar gjuhën letrare kombëtare të njësuar, pavarësisht se ajo ka qenë për ta pa asnjë dyshim "toskërishtja letrare" e ngritur në standart. Shqetësimi i gjuhëtarëve ka qenë e vazhdon të jetë edhe sot "mohimi" i kryedialektit gegë dhe - ajo që ka dëmtuar rëndë kulturën tonëkombëtare-ndalimi i shkrimit të saj pas vitit 1972.
3. Së treti, në të tre institucionet kryesore në universitete, në teatër dhe në radio shkruhet dhe flitet gjuha gege tashmë e përdorur në mënyrë masive e vështirë kjo për tu ndryshuar edhe pas kaq vitesh.
4. Së katërti, pothuaj të gjithë gjuhëtarët shkruajnë në gjuhën letrare të njësuar tash më shumë se 20 vjet pa u ankuar, sepse toskërishtja është dialekt i gjuhës shqipe mbase të detyruar për ta realizuar.

Po ndërkaq, duke gjykuar gjuhën e Buzukut, na intereson së tepërmi mesazhi që sjell ajo për kohën e sotme, përkatësisht për gjuhën e sotme shqipe. Dihet që ndërrimet në një trevë gjuhësore të përbashkët, zakonisht, nisin në qendër, ndërsa skajet ruajnë tipare më arkaike e për një kohë më të gjatë. Gjuha e Buzukut - tashmë dihet - paraqet dialektin e Veriut, një gegnishte që është mjaft pranë toskërishtes e që afrohet edhe me dialektet e arbëreshëve të Greqisë e të Italisë dhe që flet qartë. Puna që edhe sot e kësaj dite ruhen trajta të moçme në zonat anësore të truallit të shqipes e në të njëjtën kohë, disa novacione që ndajnë sistemin fonetik të gegërishtes nga toskërishtja, nuk kanë zënë vend ende në këto zona, duke përfshirë këtu edhe të folmet e trevës së Krajës e të Ulqinit me rrethe, na bëjnë të mendojmë se gegërishtja e Buzukut paraqet përafërsisht gjuhën shqipe të shek. XVI.

Përpjekjet e Buzukut, i cili - tashmë dihet - është mbështetur në një traditë të shkrimit të shqipes, detyrimisht duhen vështruar në kuadrin e kohës kur ky jetoi e punoi dhe potenciali trashëgimor. Kemi një gjuhë shqipe mendojmë të ndarë në dy kryedialekte, që janë pjesë e pandarë e pasurisë shpirtërore e kombëtare të popullit tone dhe ta flakësh poshtë do të thotë të dëmtosh veten. Në rrugën e gjatë e të vështirë të përsosjes së mëtejme të gjuhës shqipe, në radhë të parë u bie detyra gjuhëtarëve dhe studjusve të gjuhës të mendojnë si duhet zgjeruar baza e shqipes së sotme letrare. Jo për të prishur, jo për të dëmtuar, po për ta pasuruar më tej gjuhën tonë, për ta bërë atë më të larmishme, më shprehëse e më të pranueshme nga të gjithë pavarësisht dialekteve tashmë. Përpjekje të frytshme për një gjuhë shkrimi mbidialektore janë bërë edhe nga shkrimtarët e tjerë të Veriut si Budi e Bardhi. Por është Pjetër Bogdani ai që bëri përgjithësimin e të gjitha këtyre përpjekjeve edhe në fushën e normëzimit të shqipes letrare. Kjo shihet qartë te shprehja "M'asht dashtunë me djersë të mëdha shumë fjalë me ndrequnë ndë dhe të Shkodrësë". Koineja "ndë dhë të Shkodrës", domethënë në përpunimin letrar që i është bërë shqipes në këtë qendër të lashtë të kulturës shqiptare, i shërbeu autorit të "Çetës së profetëve" si model për të shkruar në pajtim me traditën. Rëndësia e autorëve të vjetër gegë e veçanërisht e Bogdanit për përpjekjet e afrimit të dialekteve maten me jehonën që patën veprat e tyre brenda e jashtë vendi në njërën anë dhe me

dobinë që i sollën kulturës kombëtare, në anën tjetër tashmë kjo e konfirmuar nga gjuhtarët dhe studjuesit e gjuhës.

Ndër shkrimtarët e Veriut që shkruanin gegnisht, përpjekje për drejtshkrim të njësuar i gjejmë te Z. Jubani e P. Vasa. Te këta autorë gjenden pika afrimi me gegnishten jugore e në ndonjë rast të veçantë edhe me toskërishten. Por, ai që ka luajtur një rol me rëndësi në këto përpjekje, ka qenë Ndre Mjeda. Nën ndikimin e K. Kristoforidhit, ai përpunoi një sistem për afrimin e të dy dialekteve. Po kështu edhe L. Gurakuqi, i cili në një artikull botuar me 1905, titulluar "Themeli i gjuhës letrare", bëri të qartë se hapi i parë për njësimin e gjuhës është njësimi i ortografisë. Katër vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit, më 1976, nën drejtimin e sociologut të njohur Xhoshua Fishman, u botua në Paris vepra e Xhenet Bajronit "Përzgjedhje ndërmjet alternativave në standartizimin e gjuhës - Rasti i shqipes. Aty mësuam se "toskërishtja ka qenë bërthama fillestare e shqipes standart". Në konferencën "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot" (Tiranë 1992) u pohua haptas se baza e gjuhës shqipe na paska qenë toskërishtja letrare! Jemi, pra, para një kundërvënijeje: më 1972 "sui generis" e "mbidialektore", më 1992 "toskërishtja letrare"! A ka vend për diskutim? Natyrisht po, sepse është prekur e lëkundur themeli i saj ndër vite dhe nga faktorë të tjerë.

Në thelbin e politikës gjuhësore të E. Hoxhës, njësimi i gjuhës nuk qe aspak qëllim më vete. Përkundrazi, qe mjet "për krijimin e unitetit moralo-politik" sepse, sipas tij, "fryma e lokalizmit të çon në pikëpamje të rrezikshme antikomuniste". E. Hoxha, pra kërkonte të mbante nën kontroll e në shërbim të ideologjisë së vet edhe gjuhën letrare kombëtare. Ky fakt nuk mund të kalohet lehtë e as rrëshqitas. Sepse ka një literaturë të tërë që vihet në shërbim të partisë-shtet për këtë qëllim. Mjafton të kujtojmë dy numra të revistës "Studime filologjike" (nr. 2, 1985 e nr. 4, 1988), organ i specializuar i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave, ku gjuhëtarët më të nderuar të vendit janë përpjekur të vërtetojnë se E. Hoxha na paska qenë filologu dhe albanologu më i madh i të gjitha kohëve. Ndër këto shkrime budallallëqet kanë arritur deri në superlativa, duke komprometuar jo vetëm dinjitetin dhe personalitetin e filologëve tanë, po duke vënë në provë edhe autoritetin shkencor të tyre. Prandaj e kanë të vështirë të pranojnë debatin. Pra, në këtë mes duhet thënë haptas se nuk është demagog E. Hoxha, po ata që i shërbyen me zell atij si idhtar të politikës së atëherëshme.

Ndalimi i gegnishtes bëhej me dy qëllime të caktuara. Së pari, "letërsia e ndaluar", e shkruar në gegnishte jo vetëm nuk i shërbente regjimit në fuqi, po i sillte dëm atij. Kjo përbënte edhe thelbin politik të "ndalimit" (përkat. mohimit) të gegërishtes letrare, që duke iu zënë fryma, do të vdiste ngadalë nga asfiksia. Së dyti, varroseshin përfundimisht autorë madhorë si Fishta etj, po edhe ata që vazhdonin të shkruanin gegërisht jashtë atdheut si Camaj e shumë e shumë të tjerë. Çështja e riafirmimit të gegërishtes letrare, pra ka të bëjë me riafirmimin e një pjese mjaft cilësore të kulturës kombëtare. Prandaj mohimi i gegërishtes atëherë edhe sot mbetet antikombëtar. Në plan të parë tani dilnin dy çështje. Së pari, njohja e kësaj "pjese cilësore" të kulturës kombëtare të mohuar dhe, së dyti, mundësia e integritit të saj në kulturën e sotme kombëtare.

Konferenca shkencore "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot" kishte një pikësynim të caktuar: të pranoheshin vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit jo vetëm si një fakt i kryer, po edhe si e vetmja zgjidhje e drejtë shkencore. A qe apo jo zgjidhje e drejtë ajo që dha Kongresi i Drejtshkrimit? Kumtesat diskutonin çështje të dyta, të cilat rrihnin për ta perfeksionuar më tej këtë zgjidhje, duke e pranuar jo vetëm si të drejtë, po edhe të pakthyeshme mbase apo të reformuar gjuhën standarde. Me gjithë kujdesin paraprak të organizuesve të konferencës, ajo nuk u zhvillua sipas parashikimeve. "Të çarat" nisën që në seancën plenare dhe vazhduan deri në diskutimet e fundit. U përplasën haptas dy

mendime, dy rryma: njëra që mbronte pa asnjë diskutim Kongresin e Drejtshkrimit; tjetra, ajo që me logjikën e fakteve, i kundërvihet së parës. Paradokset, si në tërë jetën shqiptare, qenë të pranishme edhe në konferencë. Pranohej p.sh. pa përjashtim që gjuha letrare e njësuar nuk qe ndërtuar "sui generis" (mbi bazën e të dy dialekteve, pra si gjuhë mbi- dialektore), por mbi toskërishten letrare. Ky fakt ishte i mjaftueshëm për të menduar (e natyrisht edhe për të nisur diskutimin) se zgjidhja që i dha Kongresi i Drejtshkrimit gjuhës "së njësuar" detyrimisht duhej rishikuar, sepse qe lëkundur themeli mbi të cilin mbështetej zgjidhja teorike e kësaj gjuhe "të njësuar" dhe sipas gjuhëtarëve.

Në kontaktet e intensifikuara u bë themelor komunikimi. Kjo do të thotë se çështja e gjuhës mori peshë tjetër. Sikur të shtrohet çështja: a shërben gjuha vetëm për komunikim? Është e qartë se derisa flasim në eksponojmë identitetin tonë, përkatësinë në një shtresë shoqërore, në një grup moshe, në një gjini, në një krahinë, në një shtet, etj. Elementet e mënyrës së shqiptimit të tingujve, theksi, shprehjet na klasifikojnë. Pra, gjuha shërbeka edhe për veçim, ndërsa veçimi mund të krijojë situata të drejta e të padrejta. Sido që të jetë, gjuhët bëkan variacione. Ndryshe flasim me një mik, ndryshe në polici apo në provim, ndryshe në familje e ndryshe në seancë parlamentare në Prishtinë, në Tiranë a në Shkup. Zakonisht pajtohemi se përtej këtyre ndryshimeve, ekzistojnë varietetet legjitime të gjuhës dhe të tjera që nuk janë legjitime. Sipas sociologut frëng Pierre Bourdieu, legjitimiteti prodhohet përmes lojës së mekanizmave shoqërorë. Legjitim është varieteti që çmohet i pranueshëm nga shoqëria dhe varieteti i tillë zakonisht përmban shprehje e fjalë teknike, të zgjedhura, elemente si *lidhëzat derisa, ndërsa, sikundër qe*, etj. Ai përdoret në situata të caktuara dhe karakterizohet me synimin drejt rregullsisë sa më të madhe, në mos të plotë. Këtë varietet nuk e zotërojnë të gjithë njësoj. Duke i hapur sytë para dëshmimeve sociolinguistike për faktin se planifikimet gjuhësore janë pjesë e plani-fikimeve më të gjera, të modernizimit, të integritimeve kombëtare e ndërkombëtare, politike, ekonomike, mbi të gjitha kulturore, ashtu si para faktit se janë elitat ato që drejtojnë planifikimin gjuhësor, është e nevojshme të hetohen dhe reaguesimet ndaj procesit të standardizimit dhe situatës së trashëguar.

Dialektet janë trajtuar si një burim i elementit të ri që mund të përfshihet në variantin standard. Konkretisht duhet të argumentojmë përfshirjen në leksikun e gjuhës standarde të disa fjalëve të dialektit të gegërishtes me prapashtesat inë dhe an, (prapashtesa që njihen si prodhimtare edhe tek "Gramatika e gjuhës shqipe, 1", botim i Akademisë së Shkencave). Kjo përfshirje do të shërbente për rritjen e prodhueshmërisë së këtyre dy prapashtesave në të ardhmen, e për rrjedhojë, do të ndikonte në zhvillimin jo thjesht të strukturës leksikore, por kryesisht të strukturës fjalëformuese të shqipes. Sot, kur shqipja standarde përballet me qëndrime të ndryshme, synimi ynë është që përmes këtij studimi, modest, të japim një shembull të punës konkrete me materialin gjuhësor dialektor.

Një punë e tillë, në përmasa më të gjera dhe mbi baza të shëndosha shkencore, mendoj se ngjall edhe një debat të mirëfilltë mes specialistësh, që duhet të jenë protagonistët e politikës gjuhësore në Shqipëri, për ta mbrojtur dhe pasuruar shqipen standarde. Fjalë kyçe: gjuhë standarde, strukturë leksikore, strukturë fjalëformuese, prapashtesa prodhimtare si mundësi të pasurimit të strukturës leksikore dhe fjalëformuese të shqipes prej variantit dialektor të gegërishtes. Kur flasim për gjuhën standarde shqipe, e kemi të qartë se ajo përbën një kategori historike dhe se norma letrare është e hapur. Norma dhe variacioni janë faktorë të gjallërisë së një gjuhe. Gjuha standarde shqipe është një rast 'sui generis', pasi rruga e formimit të saj nuk është një nga rastet klasike të modaliteteve të formimit të standardeve. Shqipja standarde përfshin të gjithë elementët e përbashkët të të dy dialekteve, elementët e veçantë me burim nga të dy dialektet, si dhe elementët e rinj që mund të vijnë nga të dy dialektet. Por është fakt i pamohueshëm që toskërishtja është dialekti me më shumë prurje.

Pikërisht fakti që norma letrare nuk konceptohet si e pandryshueshme, por në zhvillim, është konstatuar vazhdimisht nga gjuhëtarët, p.sh duke analizuar problemet e normës gramatikore në gramatikat e pasçlirimit, shkodrani Jup Kastrati bën një klasifikim të teksteve gramatikore, sipas kategorive të ndryshme të shkollave dhe vëren se gramatikat e kanë pasqyruar zhvillimin e normës dhe se gjuhëtarët kosovarë, duke ecur në rrugën e konvergencës gjuhësore kanë dhënë një ndihmesë të dukshme për kristalizimin e saj. Po kështu, mund të përmend Prof. Shaban Demirajn, i cili thekson se struktura morfologjike e shqipes letrare, në vija të përgjithshme, pasqyron strukturën morfologjike të gjuhës popullore dhe se ka arritur një stad të tillë zhvillimi, që i jep mundësi asaj t'i përmbushë më së miri kërkesat e një gjuhe letrare me norma të përcaktuara drejt. Ky zhvillim shihet si një rezultat i një evolucioni të gjatë, të kushtëzuar, nga dy prirje disi të kundërta, që kanë pasur dhe kanë secila fushën e vet të veprimit:

Prirja për ruajtjen dhe konsolidimin e formave gramatikore

Prirja për rrafshimin, thjeshtimin dhe rrafshimin e disa kundërvënieve dhe paradigmave. Sipas këtij studiuesi, këto dy prirje kanë vepruar, ku më shumë e ku më pak, edhe në gjuhë të tjera indoevropiane. Edhe gjatë periudhës para viteve '90, pasurimi i leksikut të shqipes ka qenë një prioritet i politikës gjuhësore në Shqipëri. Fjalët e burimit popullor janë përzgjedhur shpesh për vlerat e tyre leksiko-semantike dhe stilistike. Duke qenë se ato shënojnë nocione të reja apo kanë dhe ngjyime të veçanta kuptimore, janë vlerësuar si një mundësi për pasurimin dhe pastërtinë e gjuhës. Mbledhja sistemore dhe përpunimi leksikografik i tyre është bërë në mënyrë të organizuar. Ndoshta deri në tepri është punuar për pastrimin e terminologjisë tekniko-shkencore. Terma të veçantë dhe në mënyrë të konsiderueshme edhe sisteme terminologjike janë realizuar nga “brumi” i shqipes. Edhe sot, fondi i fjalorit vazhdon të pasurohet nga fjalë të krijuara rishtas ose nga rivlerësimi i fjalëve ekzistuese.

Natyrisht, në këtë gjuhë letrare kombëtare të njësuar kanë hyrë dhe do të hyjnë vijimisht edhe jo pak elemente të gegërishtes dhe ky është një proces real i bashkëveprimit dhe shndërrimeve të bashkësisë shoqërore shqiptare, si pasojë e lëvizjeve dhe shndërrimeve të shumta demografike dhe shoqërore kulturore, të cilat meritojnë të studiohen veçan në kërkimet e reja të dialektologjisë shqiptare dhe sociolinguistikës. Gjithë lënda që merr gjuha letrare prej dialekteve i nënshtrohet normës së saj, sidomos normës fonetike dhe normës gramatikore. Ky qëndrim, edhe sot duhet të vlejë si një parim, në mënyrë që çdo zhvillim të jetë mbi baza shkencore dhe jo spontan “sot ndodhemi në një etapë të re të historisë së kombit tonë, po edhe të shqipes standarde. Dhe si çdo etapë e re, edhe kjo na vë të gjithëve para përgjegjësive të reja, zgjidhja e të cilave nuk mund të bëhet më me teori e metoda të vjetra dhe duke u mbyllur, po duke u hapur, duke shtuar komunikimin dhe transparencën në të gjitha nivelet, pra, duhet ndryshim edhe në qëndrimin ndaj shqipes standarde, të kësaj pasurie kombëtare të krijuar e të trashëguar nga kontributi i brezave që meriton jo vetëm të ruhet, po edhe të zhvillohet e të çohet më tutje, po me një politikë gjuhësore gjithëpërfshirëse, që ka në thelbin e vet bashkëpunimin dhe mirëkuptimin. Duhet, pra, rishqyrtuar problemi në të gjithë kompleksitetin e tij, duke u përqendruar, sipas meje, në trajtimin e dy problematikave kryesore:

1. çështje teorike e praktike të zhvillimit të shqipes standarde;
2. çështje teorike e praktike të formimit gjuhësor të shqiptarëve”;

shkruan Prof. Bari Beci, duke vlerësuar nga ky këndvështrim zhvillimin e standardit. Studiuesit kosovarë, si: Rexhep Qosja, Agim Vinca, Shefkije Islamaj, Begzad Baliu, Isa Bajçina etj., vlerësojnë përdorimin e gjuhës standarde, brenda trevave shqipfolëse, si një domosdoshmëri. Konkretisht ngulmoj të argumentoj

përfshirjen në leksikon e gjuhës standarde të disa fjalëve të dialektit të gegnishtes me prapashtesat inë dhe an, (prapashtesa që njihen si prodhimtare edhe te “Gramatika e gjuhës shqipe 1”, botim i Akademisë së Shkencave). Për këtë qëllim kam shfrytëzuar fjalorin e studiuesit Avdyl Sula (Fjalor fjalësh dhe shprehjesh popullore). Në këtë fjalor, ai sjell 15 mijë fjalë dhe kuptime të reja fjalësh, njësi frazeologjike, tabu, eufemizma etj. Në parathënien e fjalorit, ky studiues shkruan: “Me kalimin e viteve, falë dhe çlirimit të Kosovës, hapjes së kufijve e thellimit të gjurmimeve në këtë fushë, vura re se shumica e tyre kishin një gjeografi përdorimi shumë më të gjerë.” Pra, ai vëren se shumica e fjalëve përdorshin dendur si në Kosovë, edhe në treva të tjera të veriut.

Duke u nisur nga fakti që struktura leksikore e gjuhës standarde shqipe përfshin dhjetëra e mijëra fjalë e njësi frazeologjike, të cilat konsiderohen si element i përbashkët i gjuhës, pavarësisht burimit dialektor, si dhe nga fakti se leksiku është një strukturë ku norma paraqitet me më shumë variante (sinonimike), duke e krahasuar me strukturat e tjera, menduam se ky fjalor mund të shërbejë si një material për studiuesit, në lidhje me pasurimin e standardit. Konkretisht, nga fjalori i sipërpërmendur kemi përzgjedhur një kategori emrash që mund të përbëjnë një pasuri jo vetëm në aspektin leksikor, por kryesisht në atë fjalëformues. Së pari, në qoftë se do t’i referoheshim strukturës fjalëformuese të shqipes standarde, prapashtesa inë, është pak e përdorshme. Ajo nuk mund të cilësohet si një prapashtesë prodhimtare. P.sh. Prof. Miço Samara, tek “Histori e gjuhës letrare shqipe”, në tipat e fjalëformimit prapashtesor nuk e përfshin tipin me këtë prapashtesë. Në botimin e Akademisë së Shkencave, “Gramatika e gjuhës shqipe 1” prapashtesa inë njihet si një nga prapashtesat që shërben për të formuar emra të përgjithshëm të vendeve, krahas prapashtesave: ishte, (ishtë); ore, tore, ajë. P.sh: çmendinë, (çmend); kodrinë (kodër); luginë (lug-u); rrafshinë (rrafsh); zallinë (zall); greminë (gremis), etj. Po në këtë botim, kjo prapashtesë cilësohet si një prapashtesë dialektore që ka fituar njëfarë përhapjeje edhe në gjuhën letrare. Ajo që mund të theksonim në këtë rast është se prapashtesa ishte duket sikur e zvogëlon mundësinë e përdorimit të prapashtesës inë. Por, pikërisht, pasi kemi analizuar të gjitha rastet e ndërtimeve me prapashtesën inë, të përfshira në fjalorin në fjalë, menduam se mund të përfshihen në gjuhën standarde disa emra të formuar nga kjo prapashtesë. Duhet theksuar se:

- a) temat fjalëformuese dialektore nuk i kanë përgjegjëset e tyre në gjuhën standarde;
- b) kjo do të sillte edhe diferencim në përdorimin e prapashtesës ishte, pasi edhe tek “Gramatika e gjuhës shqipe, 1”.

Kjo prapashtesë shihet si një prapashtesë që shërben për të formuar emra që tregojnë vend, duke iu bashkuar një teme emërore e më rrallë foljore e mbiemërore, për ta karakterizuar për nga sendi që gjendet me shumicë aty, që njëkohësisht është edhe tema fjalëformuese p.sh: ferrishtë, ahishtë, ranishtë, lulishte, pemishtë, etj, ndërkohë që ne pretendojmë që prapashtesa inë, mund të shërbejë për të formuar emra vendesh që karakterizohen nga një tipar. Për tri rastet e mëposhtme, që janë të përfshira edhe në FGJSH, krahas trajtave me prapashtesën ishte, mund të themi se krijohen dysorë normative, por që mund të diferencohen më kalimin e kohës, po qe se do të diferencohet përdorimi i këtyre prapashtesave, siç e parashtruam edhe më sipër. Krahas rrahinë, a rrah i lënë djerr dhe rrahishtë në kuptimin rrah-u tokë buke e hapur duke prerë drurët dhe shkurret.¹

Së dyti, po në kuadër të formimit prapashtesor do të sugjerim përfshirjen në gjuhën standarde të disa fjalëve të formuara me prapashtesën an. Edhe kjo prapashtesë në botimin e Prof. Samarës nuk është përfshirë në prapashtesat prodhimtare, kurse në botimin e akademisë përfshihet në grupin e prapashtesave

¹ f. 359

ar, tar, atar, or, tor, (ator), ak,as, an, (jan), it, iot, që shërbejnë për të formuar emra të përgjithshëm njerëzish të karakterizuar sipas veprimit që kryejnë, sipas tiparit të tyre, sipas mjeshtërisë që ushtrojnë, po ashtu edhe sipas vendit ku banojnë ose ku kanë lindur. Konkretisht, prapashtesës *an* dhe variantit të saj me *j (jan)* i njihet vlera si formant fjalëformues për emrat e vetave që tregojnë banorin e një vendi ose prejardhjen e tij nga një vend: *kuksian, matjan, shkodran, shaljan* etj. Kjo prapashtesë, gjithashtu, shihet me një përdorim të kufizuar në rastin e mbiemrave.

Në trajtën e një shënimi po në këtë botim thuhet se kjo prapashtesë ka një ngjyrim keqësues tek mbiemrat me karakter dialektor që kanë tema fjalëformuese emërore: *bishtan, çudan, vetullan, zhelan,* por edhe nga tema mbiemërore, si: *keqan, kuqan, kaleshan,* etj. Konkretisht, rastet e përzgjedhura nga ne janë si:

a. mbiemra që mund të përdoren edhe si emra, të cilët zëvendësojnë togun: [njeri (objekt) + parafjala me + emrin a togun që bart tiparin]: *LYERTHAN,* - E mb. edhe si em. Me *lyertha.* f. 243 *PULLAN* mb. dhe si em. Me *pulla, pullali.* f. 335 *BALUSHAN,* - E mb. edhe si em. Me *balushë* në ballë ose me *bala* në shtat. Njeri me *damkë, Balushani* i pacipë. f. 23 *VRUGAN,* E mb. edhe si em. Me *vrug,* i *vrugar.* f. 460 *LAFSHAN,* E mb. edhe si em. Me *lafshë* të madhe në kokë (për disa shpendë) f. 227 *KËRLESHAN,* E mb. edhe si em. Me *flokë* të *kërleshur.* f. 195 *PREHUCAN,* E mb edhe si em. Me *fytyrë* të *mprehtë,* të *hequr* dhe *thatime* f.332. *Dash* bardhok. 2. *Djalë* me *fytyrë* e *flokë* të *bardhë.* f. 25 b. Mbiemra që mund të përdoren edhe si emra, të cilët shënojnë personin a objektin që karakterizohet nga një tipar i caktuar, që jepet me anën e një fjalie përcaktore lidhore (mjete lidhës është përemri lidhor që). *DARDHAN,* E mb. Që i ngjet *dardhës.* *Mollë dardhane.* f. 161 *PULAN,* I m.sh. A(T) 1. *Vjedhës pulash* 2. *Djalë* i *urtë.* f. 334 *RRJEPAN,* E mb.

b. edhe si em. 1. I *rrjepur* (lëkura e *duarve* a e *fytyrës*) 2. *fig. Leckaman.* 3. Që i ka *rënë leshi* (për *kafshët*) f. 365 c. Mbiemra që mund të përdoren edhe si emra, ku prapashtesa an bart një ngjyrim keqësues dhe zëvendëson prapashtesat *aman, aluq, arraq, aç, aq, gjë* që sjell thjeshtim të strukturës fjalëformuese. *SHURDHAN,* E mb. edhe si em. i *shurdhër, shurdh.* f. 409 *SHTREMBAN,* E mb. edhe si em. 1. i *shtrembër.* f. 407 *RRUGAN,* E mb. edhe si em. *Keq. Bredharak, rrugaç* f. 368 *TRASHAN* mb. edhe si em. i *trashë.* f. 420 *SHKATËRRAN,* E mb. edhe si em. *Shkatarraq.* f. 393 *TUTËSAN,* E mb. dhe si em. *Frikacak, tutës.* f. 429 *SORRAN,* I mb. edhe si em. i *zi* si *sorra, sorrak.* f. 376 *ZVERDHAN,* E mb. edhe si em. i *verdhë,* i *zbehtë, verdhacak.* f. 484 Në këtë rast duhet të theksojmë se përdorimi i këtyre fjalëve nuk na çon tek *dysorët* normativë, pasi prapashtesat *aman, aluq, arraq, acak, aq, aç, ak,* duket se bartin një ngjyrim keqësues tallës, përqeshës. d. Mbiemra që mund të përdoren si emra, të cilët e japin tiparin a ngjyrimin keqësues, përbuzës, në shkallën më të lartë: *QORRAN,* E mb. edhe si em. i *verbër.* f. 349 *PËRLOSHAN,* E mb. edhe si emër.

Përdorimi i prapashtesës an p.sh. në fjalët *pullan, zorran,* do të mënjanonte përdorimin e prapashtesave *li, xhi,* që siç dihet janë prapashtesa të huazuara.

PËRFUNDIME

1. Mendoj se përfshirja e këtyre fjalëve në strukturën leksikore të shqipes se pasuron jo vetëm sistemin mbiemëror, por edhe atë emëror, por ajo çka është e rëndësishme është fakti se këto fjalë mund të shërbejnë jo vetëm si njësi leksikore, por edhe si modele fjalëformuese në vazhdim.
2. Synimi është të jap një shembull të punës konkrete me materialin gjuhësor dialektor.
3. Një punë e tillë, në përmasa më të gjera, dhe mbi baza të shëndosha shkencore, mendoj se ngjall edhe një debat të mirëfilltë mes specialistësh, që duhet të jenë protagonistët e politikës gjuhësore

në gjithë trevat shqipfolëse, për ta mbrojtur dhe pasuruar shqipen standard por duke u mbështetur në disa ndryshime marrë nga gegënishtja si gjuhë e pasur dhe mjaft e përdorshme në shumë krahina shqipfolëse.